



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 08-322-34852/16
Kaçanik, 28.10.2016

Në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) të nenit 29.12(b) të Ligjit Nr. 03/L -153/2010-Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3-Për Pyjet e Kosovës, të nevojës për kursimin e Buxhetit të Komunës për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse-dru për ngrohje, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 Tetor 2016, mori këtë:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MASËS DRUSORE TË KONFISKUAR,
SHKOLLAVE TË KOMUNËS**

1. Me këtë Vendim, Lejohet ndarja e masës drusore të konfiskuara në vitin 2016 që ndodhen në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës, atyre shkollave të komunës, të cilat si lëndë djegëse për ngrohje shfrytëzojnë dru.
2. Obligohet drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, të bëjë mbikëqyrjen e masës drusore që gjendet në Autoparkun e Shoqatës së Invalidëve të Luftës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltarisë, si dhe Drejtorja për Arsim dhe Kulturë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
3. Drejtorja e Arsimit dhe Kulturës,
4. Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim. dhe
5. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi